



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 13486/26

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data / Datum: 01.04.2026

VUSHTPRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 58/26 01/04/2026

Bazuar në nenin 12 në lidhje me nenin 53 shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë **31 mars 2026**, pasi ka shqyrtuar gjendjen lidhur me publikimin ekspozitës për masakrat serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë, miraton këtë:

DEKLARATË

Ne, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në cilësinë e përfaqësuesve të qytetarëve, kemi përcjellë me shqetësim hapjen e ekspozitës në sheshin “Nëna Terezë” në Prishtinë, me titull “Masakrat në Kosovë 1998–1999”, e cila është bazuar në librin me autor Shkëlzen Gashi. Ky libër, si dhe ekspozita në fjalë, paraqesin të dhëna të pasakta lidhur me masakrat në Kosovë, veçanërisht për numrin e të vrarëve dhe cilësimet e bëra për viktimat e viteve 1998–1999.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë shpreh indinjatë dhe shqetësim lidhur me këto të dhëna dhe kërkon që ato të rishikohen e të përmirësohen në përputhje me faktet e dokumentuara, në mënyrë që të pasqyrohet e vërteta e luftës në Kosovë.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë riafirmon qëndrimin e tij për mbrojtjen e së vërtetës së luftës çlirimtare të Kosovës.

Po ashtu, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon kujdes të shtuar në publikimin dhe verifikimin e të dhënave që kanë të bëjnë me masakrat e kryera në Kosovë, duke synuar ruajtjen dhe kultivimin e kujtesës kolektive të popullit të Kosovës.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

31 mars 2026

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

